



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E SHITES • OPŠTINA ŠTIMLJE • MUNICIPALITY OF SHTIME

PLANI I PUNËS SË KABINETIT TË KRYETARIT TË KOMUNËS 2026

Rr: "Tahir Sinani" - 72000 Shtime, Republika e Kosovës
E-mail: info.shtime@rks-gov.net
<https://shtime.rks-gov.net>/<https://shtime.rks-gov.net/>

Fjala e Kryetarit

Deri në vitin 2021, Komuna e Shtimes përballej me pasojat e keqqeverisjes dhe mungesës së zhvillimit, duke lënë shumë sfida për qytetarët.

Ndryshimi erdhi falë besimit tuaj, i cili u kthye në punë konkrete dhe rezultate të dukshme në çdo pjesë të komunës. Gjatë mandatit të kaluar kemi realizuar mbi 50 milionë euro investime në projekte që kanë përmirësuar jetën në qytet dhe në fshatra.

Nga një çerdhe, sot Shtimja ka pesë; janë rritur ndjeshëm subvencionet për kulturë, rini, sport dhe bujqësi, ndërsa po ndërtohen objekte të rëndësishme si QKMF-ja, Enti Special dhe objekti i ri i komunës. Janë shtuar hapësirat publike dhe janë krijuar më shumë mundësi për të rinjtë dhe studentët, përmes rritjes së bursave dhe kurseve falas në Qendrën e Inovacionit. Njëkohësisht, kemi nderuar historinë dhe sakrificën e luftës së UÇK-së, duke zhvilluar projekte me rëndësi kombëtare si Shtabi i Rancës, Memoriali i Reçakut - projekt nacional, si dhe duke investuar në rregullimin e varrezave të dëshmorëve dhe veteranëve.

Sot, Shtimja është një komunë e transformuar dhe në zhvillim të vazhdueshëm. Duke u mbështetur në këtë përvojë dhe në këto punë të mira që ndikojnë direkt në zhvillimin e Komunës sonë, qytetarët na kanë dhënë besimin edhe për një mandat tjetër katërvjeçar për periudhën 2025–2029, në mënyrë që të vazhdojmë realizimin e projekteve dhe avancimin e Shtimes. Bashkë do të vazhdojmë punët e mira që e çojnë përpara Shtimen, me punë, dinjitet dhe rezultate konkrete.

Kryetari i Komunës

Dr. Qemajl Aliu

PRIORITETET E PROGRAMIT QEVERISËS

- **Efikasitet dhe shpejtësi në trajtim të kërkesave;**
- **Transparencë e plotë në vendimarrje;**
- **Transparencë në procedura të prokurimit dhe konkurse;**
- **Transparencë për shpenzimin e buxhetit;**
- **Bashkëpunim i ngushtë me nivelin qendror dhe organizatat ndërkombëtare;**
- **Përmirësimi i shërbimeve në QKMF;**
- **Mbështetje për bizneset e vogla dhe të mesme;**
- **Nxitja e punësimit për të rinjtë dhe grate;**
- **Subvencione për bujqësinë dhe blegtorinë;**
- **Asfaltimi dhe mirëmbajtja e rrugëve lokale;**
- **Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit dhe ujësjellësit;**
- **Investime në renovimin e shkollave;**
- **Bursa për studentë;**
- **Mbështetje për familjet në nevojë;**
- **Rritje e hapësirave të gjelbra;**
- **Shënimi i ngjarjeve të rëndësishme sikurse; Përvjetori i Masakrës së Reçakut, Përvjetori i Pavarësisë, Dita e Çlirimit të Komunës, Dita e Dëshmorëve, aktivitete rinore dhe sportive etj.**

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS

Drejtoritë

- **Drejtoria e Arsimit**
- **Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale**
- **Drejtoria për Buxhet dhe Financa**
- **Drejtoria për Zhvillim Ekonomik**
- **Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi**
- **Drejtoria e Shërbimeve Publike**
- **Drejtoria e Prokurimit**
- **Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural**
- **Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport**
- **Drejtoria e Administratës së Përgjithshme**
- **Drejtoria e Inovacionit dhe Zhvillim të Projekteve**

NJËSITË NË KUADËR TË KABINETIT TË KRYETARIT TË KOMUNËS

- Zyra për Komunikim me Publikun
- Zyra Ligjore
- Zyra për Integritete Evropiane
- Zyra për Auditim të Brendshëm
- Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
- Zyra për Komunitete dhe të Drejtat e Njeriu

➤ ARSIM

- **Ndërtimi i sallave të reja** të edukatës fizike në SHFMU “Abdullah Shabani” (Zborc) dhe SHFMU “Lasgush Poradeci” (Rashincë);
- **Ndërtimi i Sallës së Sportit** në SHFMU “Hasan Prishtina” (Godanc);
- **Funksionalizimi i sallave** sportive në Muzeqinë dhe Carralevë;
- **Ndërtimi i çerdhes** në Carralevë dhe Petrovë;
- **Renovimi i disa shkollave**, përfshirë Gjimnazi “Naim Frashëri” në Shtime;
- **Rregullimi i rrethojave** të shkollave në disa lokalitete;
- **Finalizimi i projekteve** për efikasitet të energjisë në shkolla dhe në Institucionin e Arsimit dhe Aftësisimit Profesional në Shtime;
- **Ndërtimi i shkollës së re** në Vojnoc dhe sallë sportive;
- **Përgatitja teknike e lokaleve shkollore:** ngjyrosja, dezinfektimi, vendosja e xhamave të dëmtuar, riparimi i inventarit ekzistues dhe pajisja me inventar të ri;
- **Menu të shëndetshme në çerdhe** - Sigurimi i ushqimit të balancuar dhe të aprovuar nga nutricionistë në të gjitha çerdhet, duke promovuar ushqimin e shëndetshëm për fëmijët

➤ SHËNDETI PUBLIK

- **Përfundimi i ndërtimit të Entit Special dhe QKMF-së** - Sigurimi i objekteve moderne dhe funksionale për ofrimin e shërbimeve shëndetësore primare dhe të specializuara për qytetarët;+
- **Përmirësimi i Shërbimeve Shëndetësore dhe Sociale në Komunitet;**
- **Përmirësimi i shërbimeve në kujdesin shëndetësor parësor;**
- **Ofrimi i shërbimeve shëndetësore për urgjenca, vizita në shtëpi dhe mbështetje për qytetarët në çdo kohë;**
- **Shërbime të reja shëndetësore** - Angazhimi i specialistëve si logopedë, psikologë, fizioterapeutë dhe punëtorë socialë për kujdes më të plotë dhe gjithëpërfshirës;
- **Implementimi i strategjisë për personat me aftësi të kufizuara;**
- **Mbështetje financiare për kategori të ndryshme sociale;**
- **Zbatimi i projektit “Pako” për fëmijët e sapolindur në Komunën e Shtimes.**

➤ ZHVILLIMI EKONOMIK

- **Funksionalizimi i plotë i zonës së Gllavicës** - Përmirësimi i infrastrukturës dhe promovimi i zonës për investime private dhe zhvillim të aktiviteteve turistike e ekonomike.
- **Ndërtimi i transmisionit 110 kV për komunën** - Investim në rrjetin energjetik për sigurimin e furnizimit stabil me energji elektrike për bizneset dhe qytetarët.
- **Masterplani për agroturizëm dhe turizëm** - Hartimi i një strategjie zhvillimore për blegtorinë, agroturizmin dhe hotelerinë, duke promovuar potencialin lokal dhe krijimin e vendeve të reja të punës.
- **Mirëmbajtja e parkut të “Pishat”** - Restaurimi dhe zhvillimi i hapësirave rekreative për qytetarët, duke përfshirë aktivitete sportive dhe kulturore.
- **Themelimi i fondit për ndërmarrësit e rinj** - Ofrimi i mbështetjes financiare dhe këshillimore për start-up-et dhe bizneset e reja, me qëllim stimulimin e inovacionit dhe punësimit lokal.
- **Mbështetje për bizneset lokale** - Angazhimi i ekspertëve për hartimin e projekteve dhe aplikimin për fonde nga donatorë ndërkombëtarë, në mbështetje të zhvillimit të bizneseve lokale.

➤ **SPORTI**

- **Rivitalizimi i terreneve sportive** - Rikonstrukcioni i fushave dhe terreneve sportive në qytet dhe në fshatra, për të krijuar kushte moderne për zhvillimin e sportit amator dhe profesional;
- **Përkrahja e klubeve sportive** - Ofrimi i mbështetjes së qëndrueshme financiare, infrastrukturore dhe logjistike për klubet sportive, me qëllim rritjen e aktivitetit sportiv në komunë;
- **Ndërtimi** i fushave të tenisit;
- **Ndërtimi** i stadiumit në Lagjen e Pajtimit;
- **Subvencionimi i sportistëve të dalluar** - Mbështetje për sportistët që përfaqësojnë komunën dhe shtetin, duke nxitur talentet e reja dhe promovuar sukseset sportive.

➤ KULTURA

- **Kalendari kulturor vjetor** - Përgatitja e një kalendari të plotë me ngjarje artistike të organizuara nga Komuna dhe vetë artistët, për të promovuar aktivitetin kulturor gjatë gjithë vitit;
- **Inventarizimi** i Qendrës Rinore;
- **Mbështetje financiare dhe logjistike** për shoqatat dhe organizatat artistike të komunës, për zhvillimin e projekteve kulturore;
- **Përkrahja e veçantë për artistë dhe grupe artistike** të dalluara, për organizimin e aktiviteteve në komunë dhe për përfaqësim në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

➤ **BUJQËSIA**

- **Funksionalizimi i Tregut të Gjelbër** - Krijimi i një hapësire funksionale për tregtimin e produkteve bujqësore vendore, duke siguruar kushte higjienike dhe standarde të përshtatshme për shitësit dhe konsumatorët.
- **Rrjeti i kanaleve kulluese** - Hapja dhe ndërtimi i kanaleve për menaxhimin e ujërave atmosferike në fshatrat problematike, me qëllim parandalimin e përmbytjeve dhe mbrojtjen e tokave bujqësore.
- **Rrugë të reja bujqësore** - Ndërtimi i rrugëve fushore në Muzeqinë, Davidovc dhe Gjyrkoc, për të lehtësuar qasjen e fermerëve në tokat e tyre bujqësore.
- **Subvencione për fermerët** - Ofrimi i subvencioneve për mekanizëm bujqësor, inpute, fara, sera dhe kapacitete për ruajtjen e produkteve bujqësore (silosë), sipas nevojave të fermerëve.
- **Shërbime mbështetëse veterinare** - Zbatimi i programeve për fertilizim, mirëmbajtje të thundrave dhe vaksinim, me qëllim rritjen e cilësisë dhe produktivitetit të bagëtive.

➤ URBANIZMI

- **Sheshi dhe pedonalja e qytetit me parking nëntokësor** - Ndërtimi i një hapësire moderne urbane për qytetarët, e shoqëruar me infrastrukturë funksionale për parkim nëntokësor;
- **Rivitalizimi i rrugëve dhe trotuareve** - Rikonstrukcioni i plotë i infrastrukturës rrugore dhe shtigjeve për këmbësorë, për qarkullim më të sigurt dhe më funksional;
- **Rregullimi i shtratit të lumit “Shtimjanja”** - Përfundimi i punimeve dhe rregullimi i shtratit të lumit në të tri segmentet, duke rritur sigurinë dhe duke krijuar hapësira të reja rekreative;
- **Evidentimi i ndërtimeve pa leje dhe forcimi i inspektimeve në terren;**
- **Monitorimi** i zbatimit të lejeve ndërtimore;
- **Impianti i trajtimit të ujërave të zeza** - Finalizimi i sistemit të kanalizimit, kolektorit dhe impiantit për trajtimin e ujërave të zeza;
- **Planifikimi i projekteve** infrastrukturore sipas prioriteteve të qytetarëve;
- **PZHK dhe HZK** - Miratimi i Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale Komunale

➤ **SHËRBIMET PUBLIKE**

- **Mirëmbajtja e infrastrukturës në komunën e Shtimes;**
- **Gjelbërimi i qytetit** - Shtimi i sipërfaqeve të gjelbra dhe mbjellja e drunjve në rrugët dhe rrugicat e komunës;
- **Rrjeti energjetik nëntokësor** - Eliminimi i shtyllave elektrike në qendër të qytetit dhe shtrirja e rrjetit energjetik nëntokësor;
- **Ndriçimi publik 100%** - Shtrirja e sistemit të ndriçimit publik në të gjitha zonat e banuara dhe modernizimi i tij me teknologji efikase;
- **Ndërtimi i parqeve të reja;**
- **Mirëmbajtja e hapësirave publike** - Kujdes dhe mirëmbajtje e vazhdueshme për parqet, rrugët, trotualet;
- **Përmirësimin e shërbimeve lokale** dhe të infrastrukturës duke përfshirë ujësjellësin dhe kanalizimin, përpunimin e ujërave të zeza, rregullimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe transportin lokal;
- **Kujdesin për trajtimin e ujërave të zeza dhe mbeturinave të ngurta;**
- **Rregullimi i shtigjeve** për ecje Rashincë-Gllavicë.

➤ **ADMINISTRATA DHE QEVERISJA**

- **Analiza e gjendjes aktuale** të shërbimeve dhe identifikimi i procedurave për digjitalizim;
- **Buxhetimi me pjesëmarrje** - Rritja e përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrjen për planifikimin buxhetor, duke forcuar transparencën dhe përgjegjësinë institucionale;
- **Trajnime** të avancuara për stafin administrativ.

➤ PROJEKTET MADHORE

Komuna e Shtimes do të marrë rol aktiv dhe të përgjegjshëm në koordinim me nivelin qendror për përfundimin e projekteve strategjike me rëndësi kombëtare dhe lokale, duke siguruar mbështetje institucionale dhe financiare për realizimin e tyre. Projektet madhore që do të kenë prioritet të veçantë janë:

- **Memoriali i Masakrës së Reçakut** – përkujtim dhe nderim i përhershëm i sakrificës së qytetarëve, si pikë referimi kombëtare dhe ndërkombëtare.
- **Autostrada Banullë–Duhël** – lidhje e re infrastrukturore për rritjen e mobilitetit dhe zhvillimit ekonomik.
- **Linja e transmisionit 110 kV** – garantim i furnizimit stabil me energji elektrike për bizneset dhe familjet.
- **Digat e Carralevës dhe Firajës** – menaxhim i qëndrueshëm i burimeve ujore dhe siguri për furnizimin e bujqësisë dhe popullatës me ujë.
- **Ngrohja qendrore e qytetit** – zgjidhje afatgjatë për ngrohje efikase, ekologjike dhe të përballeshme për qytetarët.
- **Qendra kryesore e hendbollit të Kosovës** – projekt strategjik për sportin kombëtar, që e vendos Shtimen në hartën sportive të Kosovës dhe rajonit.